


Rritja e Integritetit të Zgjedhjeve dhe Qëndrueshmërisë së Partive Politike

Studim për 5 Bashki të Vëndit
Mars 2023



Atributet e Dokumentit

Titulli i Projektit: Rritja e Integritetit të Zgjedhjeve dhe Qëndrueshmërisë së Partive Politike

Kohëzgjatja e kontratës: 01 Shkurt 2023 – 31 Mars 2023

Donatori: Westminster Foundation for Democracy

Data: 22 Mars 2023

Ky raport u përgatit nga Fondacioni Qemal Stafa (FQS) në kuadër të projektit “Rritja e Integritetit të Zgjedhjeve dhe Qëndrueshmërisë së Partive Politike” me mbështetjen financiare të Westminster Foundation for Democracy (WFD).

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.



Tabela e Përmbajtjes

GJETJET KRYESORE.....	1
KONTEKSTI.....	1
BASHKIA DURRËS	3
Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë	4
Rezultatet e Studimit.....	6
BASHKIA ELBASAN	12
Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë	13
Rezultatet e Studimit.....	15
BASHKIA KORÇË.....	21
Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë	22
Rezultatet e Studimit.....	24
Profili i Bashkisë.....	30
BASHKIA LEZHË	30
Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë	31
Rezultatet e Studimit.....	33
BASHKIA SHKODËR.....	39
Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë	40
Rezultatet e Studimit.....	42

GJETJET KRYESORE

Në kuadër të procesit elektoral përsa i përket zgjedhjeve vendore të 14 Majit 2023, FQS, si si struktura integrale e Partisë Socialiste të Shqipërisë, ka implementuar projektin: “Rritja e Integritetit të Zgjedhjeve dhe Qëndrueshmërisë së Partive Politike”. FQS, në bazë të pyetësorëve të shpërndarë në terren lidhur me problemet mbi çështje vendore që banorët kanë, ka kryer për 5 nga bashkitë e vendit studime të thelluara me qëllim evidentimin e problematikave kryesore të perceptuara prej qytetarëve dhe që duhet të jenë në fokus të strategjive të pushtetit vendor.

Qytetarët e anketuar janë në raporte pothuajse të barabarta përsa i përket gjinisë dhe u përkasin grupmoshave nga 18 vjeç e sipër, të cilët kanë mundësinë për të ushtruar të drejtën e votimit në këto zgjedhje. Në secilën prej bashkive, të anketuarit përfaqësojnë persona me nivele të ndryshme arsimit, duke filluar nga ai 8/9-vjeçar, deri në studimet pasuniversitare, si dhe me statuse të ndryshme të punësimit.

Pjesa më e madhe e qytetarëve kanë votuar të paktën njëherë në zgjedhje të mëparshme, ku për pjesën e qytetarëve të cilët nuk kanë votuar ndonjëherë, mbizotëron arsyeja e mosmbushjes së moshës dhe më pak arsye të tjera si mospasja e interesit, mosbesimi te kandidatët e përzgjedhur për kryetarë bashkie, apo mospasja e mundësisë për pjesëmarrje në votime. Pothuajse në çdo bashki ku është fokusuar studimi, femrat janë ato me peshën më të lartë lidhur me mosvotimin.

Lidhur me nivelin e njohurive që votuesit kanë pasur mbi profilin politik të Kryetarit/ëve të Bashkisë për të cilin/ët kanë zgjedhur të votojnë, pjesa më e madhe e votuesëve është shprehur se kanë njohuri mesatare ose/dhe mbi mesatare, vota këto të ndikuar kryesisht nga profili politik i kandidatit të votuar. Lidhur me këtë, rezultatet nga studimi tregojnë për qasje pothuajse të njëjta si nga ana e femrave, ashtu edhe e meshkujve.

Në lidhje me perceptimin mbi transparencën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve, shumica e qytetarëve e perceptojnë transparencën nga ana e bashkisë në nivele mesatare ose të mira, por pesha e qytetarëve që e perceptojnë transparencën në nivele shumë të këqija ose shumë të mira nuk rezulton e ulët gjithashtu në asnjë prej bashkive.

Shumica e qytetarëve i perceptojnë pjesën më të madhe të shërbimeve publike të ofruara nga bashkia përgjithësisht në nivele të këqija dhe më pak në nivele mesatare. Shërbimet më problematike rezultojnë të jenë: Shërbimet sociale, shëndetësia, bujqësia dhe zhvillimi rural, transporti publik vendor. Shërbimet e lidhur me arsimin dhe sigurinë publike janë vlerësuar më mirë nga qytetarët të cilët shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.

Gjithashtu, qytetarët perceptojnë pjesën më të madhe të shërbimeve administrative të ofruara nga bashkia përgjithësisht në nivele të këqija dhe më pak në nivele mesatare. Shërbimi më problematik rezulton të jetë shërbimi administrativ i lidhur me ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë. Shërbimet e lidhura me nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia dhe dhënien në kohë të informacioneve të ndryshme janë vlerësuar më mirë nga qytetarët të cilët shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.

Ndër të gjitha programet buxhetore, Shërbimet publike vendore, Strehimi dhe shërbimet sociale, Arsimi, Kultura, Sporti, Turizmi dhe Rinia dhe Infrastruktura rrugore, rezultojnë si shërbimet për të cilat Bashkitë duhet t'u kushtojë më tepër rëndësi sipas perceptimeve të qytetarëve.

KONTEKSTI

Zhvillimet më të rëndësishme politike për vitin 2023 në Shqipëri priten të jenë zgjedhjet vendore që do të zhvillohen më 14 maj 2023. Këto janë zgjedhjet e dyta të mbajtura pas ndarjes administrative territoriale të vitit 2014, ku sipas ligjit 115/2014 territori i Shqipërisë u nda në 61 Bashki, të cilat u bënë funksionale në vitin 2015, pas zgjedhjeve vendore të mbajtura në këtë vit. Ndryshimi territorial u shoqërua edhe me një ligj të ri, Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ligj i cili u kaloi bashkive edhe një sërë funksionesh dhe kompetencash të tjera, duke rritur autonominë e tyre, por në të njëjtën kohë edhe përgjegjësinë dhe rolin e kryetarit të bashkisë dhe strukturave të tjera përgjegjëse.

Në këto zgjedhje, koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) fitoi 44 bashki nga 61, duke pasur mundësinë që të vërë në zbatim sa më mirë edhe Strategjinë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore të miratuar po ashtu në vitin 2015.

Në zgjedhjet e 30 qershorit 2019, për shkak të situatës politike, Partia Socialiste fitoi garën në 61 bashki të vendit. Më 6 mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet e pjeshme vendore në gjashtë bashki të Republikës së Shqipërisë për shkak të dorëheqjeve, shkarkimeve dhe përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarëve të bashkive si rezultat i zgjedhjeve vendore të 3 viteve më parë. Partia Socialiste fitoi në pesë bashki duke siguruar mbi 50% të votave. Pjesëmarrja totale në këto zgjedhje për gjashtë bashkitë ishte 33.3%.

Fondacioni Qemal Stafa, si një strukturë integrale e Partisë Socialiste të Shqipërisë, ka si objektiv kryesor të forcojë kërkimin e bazuar në fakte dhe metoda studimore për të udhëhequr Partinë Socialiste për të nisur dhe zbatuar politika kombëtare efikase. Duke qenë se tërheqja e banorëve për të votuar për kandidatë të caktuar mbetet sfida më e madhe e çdo partie në prag të zgjedhjeve, FQS ka përgatitur studime të thelluara për pesë bashki në vend, mbështetur mbi sondazhe me qytetarë. Rezultatet janë një vlerë e shtuar për çdo kandidat në mënyrë që të përshtasë strategjinë e tij zgjedhore në përputhje me nevojat e qytetarëve, duke rritur mundësitë në këtë mënyrë për të fituar garën.

Në këtë raport janë evidentuar nevojat dhe problemet që lidhen me pushtetin vendor, për të cilat banorët dëshirojnë të adresohen nga kryetarët e bashkive përkatëse. Duke qenë se prania në terren, kontaktet me njerëzit, bisedat me qytetarët janë thelbësore për të kuptuar më mirë nevojat e tyre, FQS ka hartuar dhe shpërndarë në terren pyetësorë për problemet që kanë banorët për çështjet që ata i konsiderojnë më të rëndësishme për të qenë në fokus të strategjive të pushtetit vendor.

Gjithashtu raporti synon të vendos theksin edhe në grupe specifike të votuesve. Meqënëse pjesëmarrja me bazë gjinore dhe e të rinjve në votime vazhdojnë të jenë disa nga sfidat më të mëdha për të gjitha partitë në vend, analizat janë mbështetur duke marrë në konsideratë këto grupe specifike.

BASHKIA DURRËS



Profili i Bashkisë

Bashkia Durrës është bashkia më e madhe në Qarkun Durrës dhe ka një popullsi prej 299'989 banorë sipas Regjistrimit Civil, ndërsa sipas Censurit (2011) ka një popullsi prej 175'110 banorësh. Ajo përbëhet nga 6 njësi administrative, më konkretisht Durrës, Ishëm, Katund i Ri, Manëz, Rrashbull dhe Sukth. Me një sipërfaqe totale prej 338.3 km katror, dendësia e popullsisë është 886 banorë/km katrorë sipas Regjistrimit Civil dhe 517 banorë/km katrorë sipas Censurit (2011).

Bashkia e Durrësit ndodhet në një pozicion të favorshëm në bregdetin e detit Adriatik dhe ka një potencial të konsiderueshëm burimesh natyrore. Si porti kryesor detar në Shqipëri, Durrësi është qendra kryesore logjistike dhe transportuese në vend dhe jo vetëm, kjo e lidhur ngushtë me vëllimet e larta të importeve që vijnë në këtë port dhe shpërndahen në të gjithë vendin, por ky port shërben edhe si porta hyrëse nga deti për shtetin e Kosovës. Turizmi ka qenë historikisht një nga shtytësit kryesorë të ekonomisë lokale, ndërkohë që industria ushqimore, bujqësia dhe peshkimi si dhe tregtia kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të mbështetur mirëqenien e komuniteteve.



Këshilli Bashkiak i Durrësit është i përbërë nga 51 anëtarë zgjedhur me votë qytetare nga të cilët 26 janë femra dhe 25 meshkuj. Këshilli i zgjedhur ka gjithsej 46 anëtarë nga Partia Socialiste dhe 5 anëtarë nga parti të tjera të vogla të qendrës së majtë dhe të qendrës së djathtë.


Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë

Bashkia Durrës ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social, të cilat janë të mbuluara me burimet e veta ose transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Të dhënat duke filluar nga viti 2010 tregojnë se pesha e shpenzimeve të Bashkisë Durrës me fondet e veta ka qenë në nivelet mbi 50% për 10 vite në vijim, ndryshe nga dy vitet pasuese, ku për vitin 2021 shpenzimet e bashkisë me fondet e veta mbuluan 44.17% të shpenzimeve totale të bashkisë.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur shpenzimet sipas programeve buxhetore për 4-vjeçarin e fundit, 2019-2022 ku të dhënat për vitet 2019-2021 reflektojnë realizimin e shpenzimeve, ndërsa të dhënat e vitit 2022 reflektojnë planin. Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 dhe 2022 për Bashkinë Durrës kanë shënuar rritje kundrejt vitit 2020, duke reflektuar kështu rritjen e burimeve të financimit kryesisht nga të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë, në total për 4-vjeçarin e fundit, e zënë shërbimet: Menaxhimi i mbetjeve, Arsimi, Rrjeti rrugor rural, Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi i Bashkisë dhe Shërbimet Publike Vendore.

Shpenzimet sipas programeve buxhetore	2019	2020	2021	2022 Plan	2019-2022
Menaxhimi i mbetjeve	367,855	383,294	437,426	903,723	18.20%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	438,201	493,070	357,553	500,677	15.57%
Rrjeti rrugor rural	518,471	191,482	423,168	396,039	13.30%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	203,602	249,218	413,315	499,041	11.87%
Shërbime publike vendore	170,329	85,101	93,394	208,819	4.85%
Ndriçim rrugësh	123,781	80,284	128,518	218,836	4.80%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	194,721	89,873	64,878	111,591	4.01%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	125,911	135,540	86,807	104,251	3.94%
Sport dhe argëtim	100,053	96,158	83,045	100,135	3.30%
Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	58,219	91,286	51,683	103,534	2.65%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	79,974	59,990	99,983	62,351	2.63%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	97,241	71,672	71,106	4,333	2.13%
Shërbimet e Policisë Vendore	32,268	38,376	58,470	91,374	1.92%
Planifikimi urban Vendor	48,960	50,168	12,114	14,206	1.09%
Zhvillimi i turizmit	1,988	375	2,774	23,681	0.25%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	3,993	3,364	2,658	3,340	0.12%
Total	2,877,571	2,432,954	2,531,992	3,653,818	100.00%

Grafiku ofron një paraqitje të programeve kryesore buxhetore të Bashkisë Durrës, sipas peshës mesatare që secili prej tyre zë në totalin e shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022. (Periudha 2019-2021 i referohet buxhetit faktik, ndërsa ajo për vitin 2022 i referohet planit të buxhetit).





Programet buxhetore të Bashkisë Durrës kanë pësuar ndryshime me kalimin e viteve, duke treguar për rëndësinë në rritje të disa prej këtyre zërave nga ana e pushtetit vendor. Programet për të cilat bashkia ka rritur fokusin përgjatë 4-vjeçarit 2019-2022 janë: Zhvillimi i turizmit; Menaxhimi i mbetjeve dhe Shërbimet e policisë vendore, ndërsa programet që kanë pasur tendencë rënëse në strukturën e shpenzimeve janë: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore dhe Planifikimi urban vendor. Struktura katër-vjeçare e shpenzimeve nga viti 2019 në vitin 2022 paraqitet grafiksht si më poshtë.





Rezultatet e Studimit

Në Bashkinë Durrës numri total i qytetarëve të intervistuar është 359, ndër të cilët 49% janë femra dhe 51% meshkuj. Të gjitha grupmoshat e popullatës që kanë të drejtë për të votuar u përfshinë në pyetësor ku shpeshësinë më të lartë e përbën grupmosha 35-44 vjeç me 22% të të anketuarëve dhe atë më të ulët e përbën grupmosha 65+ vjeç me 9% të të anketuarëve.





Niveli i arsimit i arritur të të anketuarëve varion nga arsimi i ulët 9 vjeçar deri në arritjen e gradës doktor shkencave, ku 48% e të anketuarëve u shprehën se zotëronin diplomën e shkollës së mesme, ndërsa 51% e tyre kishin përfunduar minimalisht studimet universitare (konkretisht 31% kishin përfunduar bachelor-in dhe 20% kishin përfunduar studimet master).



Përsa i përket statusit të punësimit, 55% e të anketuarëve rezultojnë të punësuar me kohë të plotë, 10% janë të punësuar me kohë të pjesshme, 8% janë të vetëpunësuar, ndërsa 15% janë të papunë. Jashtë forcave të punës llogaritet të jenë 12% e të anketuarëve.



Vetëm 6% e të anketuarëve (22 individë) janë shprehur se nuk kanë votuar asnjëherë më parë në zgjedhjet lokale të Bashkisë Durrës, ku shumicën prej tyre e kanë përbërë të intervistuarat femra. Pyetur mbi arsyet e mosvotimit, 43% e këtyre individëve janë shprehur se nuk kishin mbushur moshën për të pasur të drejtën e votimit. Rrjedhimisht vëmendja duhet të drejtohet drejt 57% të të anketuarëve që nuk kanë votuar për të kuptuar arsyet që çojnë në mos angazhimin në votime të qytetarëve. Pesë individë shprehen se nuk kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në votime, ndërsa dy individë nuk kanë pasur besim tek kandidatët për kryetar bashkie. Pesë prej të anketuarëve shprehen se nuk kanë pasur interes në votime.





Personat të cilët kishin votuar minimalisht njëherë gjatë zgjedhjeve lokale të Bashkisë Durrës, u pyetën sa njohuri kanë pasur mbi profilin politik të Kryetarit/ëve të Bashkisë për të cilin/ët kanë zgjedhur të votojnë. Ndër 359 persona të përgjigjur, 70% u shprehën se kanë pasur njohuri mbi mesataren (25% kanë pasur njohuri të mira dhe 45% shumë njohuri) mbi profilet politike të kandidatëve. Ndër 359 persona 20% vlerësojnë se kanë pasur njohuri mesatare dhe 6% dhe 4% e të anketuarëve shprehen se kanë pasur pak dhe aspak njohuri dhe informacion respektivisht. Lidhur me këtë pyetje, nuk vihen re diferenca theksuara në përgjigje ndërmjet dy gjinive.



Pyetur mbi ndikimin e profilit politik të kandidatit për kryetar bashkie në votën e qytetarit, rezultatet e pyetësorit tregojnë se 75% e të anketuarëve votojnë bazuar në profilin politik që kandidati për kryetar bashkie prezanton (pjesa më e madhe, 57% e të anketuarëve shprehen se vota e tyre është ndikuar shumë nga profili politik i kandidatit). Personat që ndikohen mestarisht nga profili politik për të votuar përbëjnë 13% të të anketuarëve, ndërsa vetëm 12% shprehen se ndikohen pak ose aspak nga profili politik për të votuar. Femrat dhe meshkujt duken të kenë qasje të ngjashme në votimin e kandidatëve për kryetar bashkie ndikuar nga profili i tyre politik, me ndikim relativisht më të theksuar te meshkujt.

Bazuar mbi perceptimet e qytetarëve, të dhënat e pyetësorit tregojnë se 57% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët e kaluar për kryetar bashkie kanë pasur njohuri dhe kanë qenë të mirë informuar mbi problematikat e bashkisë në përgjithësi (36% mendojnë se njohuritë e kandidatëve kanë qenë shumë të mira). 26% e tyre mendojnë se kandidatët e kaluar kanë pasur njohuri mesatare dhe pjesa tjetër prej 9% dhe 8% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët kanë qenë pak ose aspak të informuar mbi problematikat e bashkisë që synonin të drejtonin. Të dhënat tregojnë për perceptime të përafërta në përqindje si te femrat, ashtu edhe te meshkujt.

Në lidhje me perceptimin mbi transparencën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve, 32% e të anketuarëve shprehen se Bashkia Durrës është shumë ose mjaftueshëm transparente në ofrimin e shërbimeve, 21% shprehen se bashkia është mesatarisht transparente dhe pjesa tjetër prej 49% shprehen se bashkia është pak ose aspak transparente, pa pasur dallim të rëndësishme në perceptimin qytetar sipas gjinisë.




Të gjithë të anketuarit kanë shprehur perceptimin e tyre në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme publike në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Vihet re se për shumicën prej shërbimeve publike të ofruara, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhet rreth niveleve shumë keq dhe mesatar, me përjashtim të atyre të lidhura me arsimin parashkollor dhe atë pasuniversitar, si dhe fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.


Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve publike të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[ujin e pijshëm, ujërat e ndotur, ujërat e shiut]	53%	23%	20%	3%	1%	100%
[rrugët dhe sinjalizimin rrugor, ndriçimin, trotualet dhe sheshet publike]	18%	25%	41%	15%	1%	100%
[transportin publik vendor]	15%	30%	38%	16%	1%	100%
[parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike]	20%	26%	35%	18%	1%	100%
[arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar]	9%	12%	12%	65%	2%	100%
[shëndetësinë]	79%	12%	6%	2%	1%	100%
[planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit]	19%	36%	36%	7%	2%	100%
[shërbimet sociale (krijimi dhe administrimi i shërbimeve, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social dhe qendrat përkatëse)]	67%	20%	11%	1%	1%	100%
[fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese]	25%	18%	31%	26%	1%	100%
[mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit]	37%	30%	26%	6%	1%	100%
bujqësinë dhe zhvillimin rural]	43%	29%	21%	5%	1%	100%
[zhvillimin ekonomik vendor (tregjet publike, bizneset e vogla, panaiet, etj.)]	59%	24%	14%	2%	1%	100%
[sigurinë publike (mbrojtja civile, zjarrfikëse)]	62%	23%	12%	2%	1%	100%

Për shërbimet publike në përgjithësi, pjesa më e madhe e qytetarëve (38%) janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është poshtë mesatares. Më problematike rezultojnë të jenë shërbimi i ofruar në lidhje me shëndetësinë dhe shërbimet sociale ku 91% dhe 87% e të anketuarëve respektivisht thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimet e lidhur me arsimin dhe fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese janë vlerësuar më mirë ku 67% dhe 27% e të anketuarëve respektivisht shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



Pyetur mbi programet e shpenzimeve buxhetore dhe shërbimet e ofruara nga bashkia, qytetarët janë shprehur se sipas perceptimit të tyre, programet që duhet t'ju kushtohet më shumë rëndësi janë: Arsimi, Strehimi dhe shërbimet sociale, Shërbimet publike vendore, Infrastruktura rrugore dhe Kultura, sporti, turizmi dhe rinia. Ndërkohë, për programin e perceptuar nga qytetarët si më të rëndësishëm,



pesha e shpenzimeve nga bashkia kundrejt totalit të shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022 paraqitet si në grafik. Pas një rritjeje në vitin 2020, pjesa e buxhetit e adresuar për arsimin është ulur. Në total për 4 vjeçarin 2019- 2022, bashkia ka shpenzuar 17.2% të buxhetit të saj për këtë shërbim.


Qytetarët kanë shprehur perceptimin e tyre edhe në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve administrative në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Njësoj sikurse për shërbimet publike, edhe për shërbimet administrative vihet re se, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhetet rreth niveleve shumë keq dhe mesatar.

Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve administrative të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia]	59%	25%	12%	4%	0%	100%
[dhënies së informacioneve në kohë të kërkuara nga qytetarët]	60%	25%	12%	3%	0%	100%
[informimin në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet e ndryshme në territorin e bashkisë]	62%	23%	12%	3%	1%	100%
[ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë]	63%	24%	11%	2%	1%	100%

Për shërbimet administrative, 61% e të anketuarëve janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është poshtë mesatares. Më problematike rezulton të jetë shërbimi administrativ i lidhur me ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë ku 87% e të anketuarëve thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimi i lidhur me nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia është vlerësuar më mirë ku 4% e të anketuarëve shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.







Në Bashkinë Durrës, 18% e të anketuarëve e njohin të drejtën për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë, ku pjesa më e madhe e tyre i përket gjinisë femërore. Vetëm 3% e tyre e ushtrojnë këtë të drejtë në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet tregojnë se 11% e këtyre individëve kanë marrë pjesë disa herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga Bashkia dhe 16% e tyre kanë marrë pjesë vetëm një herë. Pjesa më e madhe e tyre, 70% nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto mbledhje pavarësisht se e njohin këtë si një

të drejtë qytetare.

Rezultatet me bazë gjinore tregojnë se ekziston një hendek përse i përket këtij treguesi, ku nga totali i qytetarëve që e njohin të drejtën e tyre, por nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto aktivitete, femrat zënë peshën më të madhe. Nga ana tjetër, edhe përse i përket peshës së të anketuarëve që kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla, femrat janë pothuajse të vetmet pjesëmarrëse.

Personat të cilët u shprehën se kanë marrë pjesë të paktën një herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultimet publike të organizuara nga bashkia u pyetën nëse janë ndjerë të dëgjuar apo jo nga bashkia. Vetëm 19% u shpreh se janë ndjerë shumë ose mjaftueshëm të dëgjuar si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat që ata kanë shprehur, 33% mendojnë se janë dëgjuar mesatarisht dhe vpjesa më e madhe, 48% mendojnë se nevojat dhe problematikat e ngritura nga ta janë dëgjuar pak ose aspak nga bashkia.



BASHKIA ELBASAN



Profili i i Bashkisë

Bashkia Elbasan është bashkia më e madhe në Qarkun Elbasan dhe ka një popullsi prej 205'892 banorë sipas Regjistrimit Civil, ndërsa sipas Censurit (2011) ka një popullsi prej 141'714 banorësh dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 872.03 km katrorë. Dendësia e popullsisë është 236 banorë/km katror sipas Regjistrimit Civil dhe 162 banorë/km katror sipas Censurit (2011). Bashkia

Elbasan përbëhet nga 13 njësi administrative, më konkretisht Elbasan, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirgjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër. Bashkia Elbasan ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra. Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60% të popullsisë së bashkisë, ndërsa pjesa tjetër është e ndarë përkatësisht në njësitë administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore.

Bashkia e Elbasanit ka një pasuri të konsiderueshme të burimeve natyrore që krijojnë bazën e një ekonomie të diversifikuar duke ndërthurur mikpritjen dhe turizmin me prodhimin, si dhe industrinë ushqimore dhe minierat. Bashkia ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë fabrikën e çelikut, atë të çimentos, ferrokromit, etj. Një pjesë e njësisë administrative shtrihen përgjatë luginës së Elbasanit, por më shumë se gjysma e ish-komunave gjenden në një seri zonash malore, duke filluar nga Graceni e duke vazhduar me Labinot Mal, Gjinarin e Zavalinën apo edhe ish-komuna Funar. Parku kombëtar i Gjinarit në krahinën historike të Shpatit është i përshtatshëm për turizëm të natyrës dhe të kulturës.



Këshilli Bashkiak i Elbasanit është i përbërë nga 51 anëtarë zgjedhur me votë qytetare nga të cilët 24 janë femra dhe 27 meshkuj. Këshilli i zgjedhur ka në total 43 anëtarë nga Partia Socialiste dhe 8 anëtarë nga partitë e vogla të qendrës së majtë dhe qendrës së djathtë.


Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë

Bashkia Elbasan ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën, të cilat janë të mbuluara me burimet e veta ose transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Të dhënat duke filluar nga viti 2010 tregojnë se pesha e shpenzimeve të Bashkisë Elbasan me fondet e veta ka qenë në nivelet rreth 50%, ku për vitin 2021 shpenzimet e bashkisë me fondet e veta mbuluan 47.96% të shpenzimeve totale të bashkisë.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur shpenzimet sipas programeve buxhetore për 4-vjeçarin e fundit, 2019-2022 ku të dhënat për vitet 2019-2021 reflektojnë realizimin e shpenzimeve, ndërsa të dhënat e vitit 2022 reflektojnë planin. Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 dhe 2022 për Bashkinë Elbasan kanë shënuar ulje kundrejt vitit 2020, duke reflektuar kështu rënien e fondeve të qeverisë qendrore për investime. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë, në total për 4-vjeçarin e fundit, e zënë shërbimet: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Arsimi, Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi i Bashkisë, Rrjeti rrugor rural dhe Shërbimet Publike Vendore.

Shpenzimet sipas programeve buxhetore	2019	2020	2021	2022 Plan	2019-2022
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	1,552,639	2,019,176	1,944,605	1,036,730	41.78%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	391,080	433,626	413,555	478,904	10.95%
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	363,028	341,447	338,604	422,156	9.34%
Rrjeti rrugor rural	229,064	201,752	136,884	464,202	6.58%
Shërbime publike vendore	302,976	169,263	185,224	203,956	5.49%
Menaxhimi i mbetjeve	108,746	90,476	124,836	190,720	3.28%
Ndriçim rrugësh	101,897	112,664	107,087	135,119	2.91%
Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	104,806	117,111	95,519	107,100	2.71%
Menaxhimi i infrastrukturës i ujitjes dhe kullimit	132,253	117,796	28,153	33,501	1.99%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	67,564	71,332	51,609	100,173	1.85%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	70,892	55,686	59,608	84,794	1.73%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	40,089	56,609	45,568	124,700	1.70%
Çështje financiare dhe fiskale	73,332	61,125	50,754	54,632	1.53%
Të tjera	20,642	852	6,229	197,228	1.43%
Sport dhe argëtim	48,354	38,644	56,393	73,632	1.38%
Administrimi I pyjeve dhe kullotave	28,242	14,803	27,004	83,135	0.98%
Arsimi profesional	28,199	34,746	83,415	0	0.93%
Shërbimet e Policisë Vendore	26,445	26,602	25,971	31,130	0.70%
Gjendja civile	17,519	24,910	15,894	16,395	0.48%
Strehimi social	11,120	18,827	27,293	16,948	0.47%
Sigurimi shoqëror	9,453	11,872	11,190	15,453	0.31%
Planifikimi Urban Vendor	2,531	12,613	11,848	5,011	0.20%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	2,713	1,797	3,070	3,400	0.07%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	1,628	1,709	1,639	1,810	0.04%
Totali	3,775,601	4,088,917	3,940,119	3,880,829	100%

Grafiku ofron një paraqitje të programeve kryesore buxhetore të Bashkisë Elbasan, sipas peshës mesatare që secili prej tyre zë në totalin e shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022. (Periudha 2019-2021 i referohet buxhetit faktik, ndërsa ajo për vitin 2022 i referohet planit të buxhetit).





Programet buxhetore të Bashkisë Elbasan kanë pësuar ndryshime me kalimin e viteve, duke treguar për rëndësinë në rritje të disa prej këtyre zërave nga ana e pushtetit vendor. Programet për të cilat bashkia ka rritur fokusin përgjatë 4-vjeçarit 2019- 2022 janë: Administrimi i pyjeve dhe kullotave, Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile dhe Rrjeti rrugor rural, ndërsa programet që kanë pasur tendencë rënëse në strukturën e shpenzimeve janë: Arsimi Profesional; Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe Kujdesi social për familjet dhe fëmijët. Struktura katër-vjeçare e shpenzimeve nga viti 2019 në vitin 2022 paraqitet grafikisht si më poshtë.





Rezultatet e Studimit

Në Bashkinë Elbasan numri total i qytetarëve të intervistuar është 353, ndër të cilët 51% janë femra dhe 49% meshkuj. Të gjitha grupmoshat e popullatës që kanë të drejtë për të votuar u përfshinë në pyetësor ku shpeshitësinë më të lartë e përbën grupmosha 35-44 vjeç me 24% të të anketuarëve dhe atë më të ulët e përbën grupmosha 18-24 vjeç me 12% të të anketuarëve.





Niveli i arsimit i arritur të të anketuarëve varion nga arsimi i ulët 9 vjeçar deri në arritjen e gradës doktor i shkencave, ku 27% e të anketuarëve u shprehen se zotëronin diplomën e shkollës së mesme, ndërsa 59% e tyre kishin përfunduar minimalisht studimet universitare (konkretisht 22% kishin përfunduar bachelor-in dhe 37% kishin përfunduar studimet master).



Përsa i përket statusit të punësimit, 40% e të anketuarëve rezultojnë të punësuar me kohë të plotë, 10% janë të punësuar me kohë të pjesshme, 11% janë të vetëpunësuar, ndërsa 18% janë të papunë. Jashtë forcave të punës llogaritet të jenë 21% e të anketuarëve të cilët rezultojnë të jenë kryesisht femra.



Vetëm 9% e të anketuarëve (30 individë) janë shprehur se nuk kanë votuar asnjëherë më parë në zgjedhjet lokale të Bashkisë Elbasan, ku shumicën prej tyre e kanë përbërë të intervistuarat femra. Pyetur mbi arsyet e mosvotimit, 43% e këtyre individëve janë shprehur se nuk kishin mbushur moshën për të pasur të drejtën e votimit. Rrjedhimisht vëmendja duhet të drejtohet drejt 57% të të anketuarëve që nuk kanë votuar për të kuptuar arsyet që çojnë në mos angazhimin në votime të qytetarëve. Pesë individë shprehen se nuk kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në votime, ndërsa tre individë nuk kanë pasur besim tek kandidatët për kryetar bashkie. Në pjesë relativisht e vogël e të anketuarëve shprehen se nuk kanë pasur interes në votime. Vihet re që personat që janë shprehur se nuk kanë pasur mundësi të votonin, 5 gjithsej, janë të gjitha femra.





Personat të cilët kishin votuar minimalisht njëherë gjatë zgjedhjeve lokale të Bashkisë Elbasan, u pyetën sa njohuri kanë pasur mbi profilin politik të Kryetarit/ëve të Bashkisë për të cilin/ët kanë zgjedhur të votojnë. Ndër 323 persona të përgjigjur, 46% u shprehën se kanë pasur njohuri mbi mesataren (21% kanë pasur njohuri të mira dhe 35% shumë njohuri) mbi profilet politike të kandidatëve. Ndër 323 persona 22% vlerësojnë se kanë pasur njohuri mesatare dhe 19% dhe 13% e të anketuarëve shprehen se kanë pasur pak dhe aspak njohuri dhe informacion respektivisht. Lidhur me këtë pyetje, nuk vihen re diferenca në përgjigje ndërmjet dy gjinive.



Pyetur mbi ndikimin e profilit politik të kandidatit për kryetar bashkie në votën e qytetarit, rezultatet e pyetësorit tregojnë se 42% e të anketuarëve votojnë bazuar në profilin politik që kandidati për kryetar bashkie prezanton (pjesa më e madhe, 24% e të anketuarëve shprehen se vota e tyre është ndikuar shumë nga profili politik i kandidatit). Personat që ndikohen mestarisht nga profili politik për të votuar përbëjnë 23% të të anketuarëve, ndërsa 35% shprehen se ndikohen pak ose aspak nga profili politik për të votuar. Femrat dhe meshkujt duken të kenë të njëjtën qasje në votimin e kandidatëve për kryetar bashkie ndikuar nga profili i tyre politik.

Bazuar mbi perceptimet e qytetarëve, të dhënat e pyetësorit tregojnë se 39% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët e kaluar për kryetar bashkie kanë pasur njohuri dhe kanë qenë të mirë informuar mbi problematikat e bashkisë në përgjithësi (21% mendojnë se njohuritë e kandidatëve kanë qenë shumë të mira). 27% e tyre mendojnë se kandidatët e kaluar kanë pasur njohuri mesatare dhe pjesa tjetër prej 22% dhe 12% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët kanë qenë pak ose aspak të informuar mbi problematikat e bashkisë që synonin të drejtonin. Të dhënat tregojnë për të njëjtin perceptim në përqindje si te femrat, ashtu edhe te meshkujt.


Në lidhje me perceptimin mbi transparencën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve, 40% e të anketuarëve shprehen se Bashkia Elbasan është shumë ose mjaftueshëm transparente në ofrimin e shërbimeve, 21% shprehen se bashkia është mesatarisht transparente dhe pjesa tjetër prej 39% shprehen se bashkia është pak ose aspak transparente, pa pasur dallim të rëndësishme në perceptimin qytetar sipas gjinisë.




Të gjithë të anketuarit kanë shprehur perceptimin e tyre në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme publike në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Vihet re se për secilin prej shërbimeve publike të ofruara, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhet rreth niveleve shumë keq dhe mesatar.

Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve publike të lidhura me:						
	1	2	3	4	5	Totali
[ujin e pijshëm, ujërat e ndotur, ujërat e shiut]	29%	31%	27%	8%	5%	100%
[rrugët dhe sinjalizimin rrugor, ndriçimin, trotuaret dhe sheshet publike]	22%	32%	29%	13%	5%	100%
[transportin publik vendor]	30%	31%	25%	9%	5%	100%
[parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike]	29%	27%	25%	12%	7%	100%
[arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar]	14%	39%	30%	12%	6%	100%
[shëndetësinë]	29%	35%	23%	8%	5%	100%
[planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit]	20%	35%	30%	11%	5%	100%
[shërbimet sociale (krijimi dhe administrimi i shërbimeve, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social dhe qendrat përkatëse)]	27%	28%	29%	10%	5%	100%
[fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese]	19%	32%	33%	11%	6%	100%
[mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit]	38%	26%	23%	8%	5%	100%
bujqësinë dhe zhvillimin rural]	32%	33%	22%	8%	5%	100%
[zhvillimin ekonomik vendor (tregjet publike, bizneset e vogla, panairët, etj.)]	21%	39%	26%	10%	5%	100%
[sigurinë publike (mbrojtja civile, zjarrfikëse)]	26%	25%	30%	12%	7%	100%

Për shërbimet publike në përgjithësi, pjesa më e madhe e qytetarëve (57%) janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është poshtë mesatares. Më problematike rezultojnë të jenë shërbimi i ofruar në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetin dhe bujqësinë dhe zhvillimin rural ku 66% dhe 65% e të anketuarëve respektivisht thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimet e lidhur me sigurinë publike dhe rrugët dhe sinjalizimin rrugor janë vlerësuar më mirë ku 19% dhe 18% e të anketuarëve respektivisht shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



Pyetur mbi programet e shpenzimeve buxhetore dhe shërbimet e ofruara nga bashkia, qytetarët janë shprehur se sipas perceptimit të tyre, programet që duhet t'ju kushtohet më shumë rëndësi janë: Shërbimet publike vendore, Strehimi dhe shërbimet sociale, Arsimi, Infrastruktura rrugore dhe Kultura, sporti, turizmi dhe rinia. Ndërkohë, për programin e perceptuar nga qytetarët si më të rëndësishëm,



pesha e shpenzimeve nga bashkia kundrejt totalit të shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022 paraqitet si në grafik. Pas një uljeje në vitin 2020, pjesa e buxhetit e adresuar për shërbimet publike vendore është rritur. Në total për 4 vjeçarin 2019- 2022, bashkia ka shpenzuar 5.4% të buxhetit të saj për këtë shërbim.

Qytetarët kanë shprehur perceptimin e tyre edhe në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve administrative në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Njësoj sikurse për shërbimet publike, edhe për shërbimet administrative vihet re se, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhetet rreth niveleve shumë keq dhe mesatar.


Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve administrative të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia]	19%	35%	25%	13%	8%	100%
[dhënies së informacioneve në kohë të kërkuara nga qytetarët]	21%	32%	28%	13%	6%	100%
[informimin në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet e ndryshme në territorin e bashkisë]	29%	27%	26%	11%	7%	100%
[ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë]	29%	31%	23%	11%	5%	100%

Për shërbimet administrative, 55% e të anketuarëve janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është poshtë mesatares. Më problematike rezulton të jetë shërbimi administrativ i lidhur me ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë ku 60% e të anketuarëve thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimi i lidhur me nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia është vlerësuar më mirë ku 21% e të anketuarëve shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



A e njihni të drejtën tuaj për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë?




Në Bashkinë Elbasan, 74% e të anketuarëve e njohin të drejtën për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë por vetëm 10% e tyre e ushtrojnë këtë të drejtë në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet tregojnë se 39% e këtyre individëve kanë marrë pjesë disa herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga Bashkia dhe 15% e tyre kanë marrë pjesë vetëm një herë. Një masë e konsiderueshme, 36% nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto mbledhje pavarësisht se e njohin këtë si një të drejtë qytetare.


Rezultatet me bazë gjinore tregojnë se ekziston një hendek përse i përket këtij treguesi, ku nga totali i qytetarëve që e njohin të drejtën e tyre, por nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto aktivitete, femrat zënë dy-fishin e peshës së meshkujve, dhe rreth gjysmën e peshës për pjesëmarrjet me nga njëherë ose në mënyrë të vazhdueshme.

Personat të cilët u shprehën se kanë marrë pjesë të paktën një herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultimet publike të organizuara nga bashkia u pyetën nëse janë ndjerë të dëgjuar apo jo nga bashkia. Pjesa më e madhe e tyre, 53% u shpreh se janë ndjerë shumë ose mjaftueshëm të dëgjuar si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat që ata kanë shprehur, 26% mendojnë se janë dëgjuar mesatarisht dhe vetëm 21% mendojnë se nevojat dhe problematikat e ngritura nga ta janë dëgjuar pak ose aspak nga bashkia.

Sa herë keni marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga bashkia?



Sa jeni dëgjuar ju si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat e lidhura me pushtetin vendor?



BASHKIA KORÇË

Profili i Bashkisë



Bashkia Korçë është bashkia më e madhe në Qarkun Korçë me një popullsi prej 129'065 banorë sipas Regjistrimit Civil, ndërsa sipas Censurit (2011) me një popullsi prej 75'994 banorësh. Ajo përbëhet nga 8 njësi administrative, më konkretisht, Korçë, Qendra e Bulgarecit, Drenovë, Lekas, Mollaj, Vithkuq, Voskop dhe Voskopojë. Me një sipërfaqe totale prej 805.99 km katror, dendësia e popullsisë është 161 banorë/km katror sipas Regjistrimit Civil dhe 94 banorë/km katror sipas Censurit (2011).

Bashkia e Korçës ka një vendndodhje strategjike në pjesën juglindore të vendit në kufi me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë, një pozicion që ka lejuar që Korça të jetë një pikë hyrje për një vëllim të lartë të importeve totale të vendit, duke nxitur kështu tregtinë në rajon dhe më gjerë. Turizmi dhe bujqësia janë gjithashtu sektorë të rëndësishëm për ekonominë vendase, por vlen të theksohet se ekonomia e bashkisë ka ende një potencial të konsiderueshëm të pashfrytëzuar për rritje në këto sektorë. Voskopoja, Dardha dhe Boboshtica janë vetëm disa nga atraksionet kryesore turistike për të shijuar traditën vendase të kuzhinës dhe mikpritjes. Për sa i përket produkteve bujqësore, Korça furnizon të gjithë vendin me varietete cilësore të produkteve bio.



Këshilli Bashkiak i Korçës është i përbërë nga 41 anëtarë zgjedhur me votë qytetare nga të cilët 19 janë femra dhe 22 meshkuj. Këshilli i zgjedhur ka gjithsej 33 anëtarë nga Partia Socialiste dhe 8 anëtarë nga parti të tjera të vogla të qendrës së majtë dhe të qendrës së djathtë.


Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë

Bashkia Korçë ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën, të cilat janë të mbuluara me burimet e veta ose transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Të dhënat tregojnë se, duke filluar nga viti 2012, pjesa më e madhe e shpenzimeve të Bashkisë Korçë është mbuluar nga fondet e veta të bashkisë, ku për vitin 2021 shpenzimet e bashkisë me fondet e veta mbuluan 68.04% të shpenzimeve totale të bashkisë.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur shpenzimet sipas programeve buxhetore për 4-vjeçarin e fundit, 2019-2022 ku të dhënat për vitet 2019-2021 reflektojnë realizimin e shpenzimeve, ndërsa të dhënat e vitit 2022 reflektojnë planin. Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 për Bashkinë Korçë kanë shënuar ulje kundrejt vitit 2020 por për vitin 2022 bashkia planifikoi një rritje me 12% kundrejt vitit 2021. Shërbimet më të financuara të bashkisë, në total për 4-vjeçarin e fundit, janë: Arsimi, Shërbimet publike vendore, Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi i Bashkisë dhe Menaxhimi i mbetjeve.

Shpenzimet sipas programeve buxhetore	2019	2020	2021	2022 Plan	2019-2022
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	312,136	267,695	309,157	316,442	15.83%
Shërbime publike vendore	262,569	248,456	321,396	363,058	15.70%
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	515,407	601,773	12,649	13,424	15.02%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	164,865	103,790	93,793	160,896	6.87%
Menaxhimi i mbetjeve	84,435	102,621	132,653	120,008	5.78%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	125,674	96,969	68,607	82,661	4.91%
Sport dhe argëtim	57,610	70,218	107,546	125,135	4.74%
Rrjeti rrugor rural	140,349	63,287	14,466	77,067	3.88%
Ndriçim rrugësh	61,231	59,759	59,624	80,287	3.43%
Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	106,592	60,491	37,731	47,566	3.32%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	32,686	41,487	45,093	85,882	2.69%
Çështje financiare dhe fiskale	38,231	45,317	47,927	66,528	2.60%
Planifikimi Urban Vendor	91,035	10,009	11,806	29,272	1.87%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	33,348	34,649	31,259	36,270	1.78%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	38,109	21,228	42,820	26,859	1.69%
Arsimi profesional	41,941	36,703	21,384	22,114	1.60%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	17,243	25,622	30,532	34,399	1.42%
Zhvillimi i turizmit	9,552	6,366	12,839	48,682	1.02%
Strehimi social	10,589	8,349	6,887	14,599	0.53%
Shërbimet e Policisë Vendore	7,945	8,196	8,848	14,371	0.52%
Sigurimi shoqëror	6,225	3,955	1,549	4,384	0.21%
Totali	2,248,773	1,997,576	1,484,215	1,882,002	100%

Grafiku ofron një paraqitje të programeve kryesore buxhetore të Bashkisë Korçë, sipas peshës mesatare që secili prej tyre zë në totalin e shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022. (Periudha 2019-2021 i referohet buxhetit faktik, ndërsa ajo për vitin 2022 i referohet planit të buxhetit).





Programet buxhetore të Bashkisë Korçë kanë pësuar ndryshime me kalimin e viteve, duke treguar për rëndësinë në rritje të disa prej këtyre zërave nga ana e pushtetit vendor. Programet për të cilat bashkia ka rritur fokusin përgjatë 4-vjeçarit 2019-2022 janë: Zhvillimi i turizmit; Arsimi i mesëm i përgjithshëm, Shërbimet e Policisë Vendore dhe Sport dhe argëtim, ndërsa programet që kanë pasur tendencë rënëse në strukturën e shpenzimeve janë: Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara; Arsimi Profesional dhe Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Struktura katër-vjeçare e shpenzimeve nga viti 2019 në vitin 2022 paraqiten grafiksht si më poshtë.





Rezultatet e Studimit

Në Bashkinë Korçë numri total i qytetarëve të intervistuar është 352, ndër të cilët 46% janë femra dhe 54% meshkuj. Të gjitha grupmoshat e popullatës që kanë të drejtë për të votuar u përfshinë në pyetësor ku shpesh tësinë më të lartë e përbën grupmosha 35-44 vjeç me 28% të të anketuarëve dhe atë më të ulët e përbën grupmosha 65+ vjeç me 10% të të anketuarëve.





Niveli i arsimit i arritur të të anketuarëve varion nga arsimi i ulët 9 vjeçar deri në arritjen e gradës doktor i shkencave, ku 44% e të anketuarëve u shprehen se zotëronin diplomën e shkollës së mesme, ndërsa 47% e tyre kanë përfunduar studimet universitare (konkretisht 28% kishin përfunduar bachelor-in dhe 19% kishin përfunduar studimet master).



Përsa i përket statusit të punësimit, 36% e të anketuarëve rezultojnë të punësuar me kohë të plotë, 9% janë të punësuar me kohë të pjesshme, 10% janë të vetëpunësuar, ndërsa 19% janë të papunë. Jashtë forcave të punës llogaritet të jenë 26% e të anketuarëve.



Vetëm 15% e të anketuarëve janë shprehur se nuk kanë votuar asnjëherë më parë në zgjedhjet lokale të Bashkisë Korçë, ku shumicën prej tyre e kanë përbërë të intervistuarat femra. Pyetur mbi arsyet e mosvotimit, 86% e këtyre individëve janë shprehur se nuk kishin mbushur moshën për të pasur të drejtën e votimit. Rrjedhimisht vëmendja duhet të drejtohet drejt 14% të të anketuarëve që nuk kanë votuar për të kuptuar arsyet që çojnë në mos angazhimin në votime të qytetarëve. Rreth 6% e të anketuarëve shprehen se nuk kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në votime dhe po 6% shprehen se nuk kanë pasur besim tek kandidatët. Në pjesë relativisht e vogël e të anketuarëve (2%) shprehen se nuk kanë pasur interes në votime. Vihet re që personat që janë shprehur se nuk kanë pasur interes të votonin janë të gjitha femra.





Personat të cilët kishin votuar minimalisht njëherë gjatë zgjedhjeve lokale të Bashkisë Korçë, u pyetën sa njohuri kanë pasur mbi profilin politik të Kryetarit/ëve të Bashkisë për të cilin/ët kanë zgjedhur të votojnë. Ndër 298 persona të përgjigjur, 57% u shprehën se kanë pasur njohuri mbi mesataren (49% kanë pasur njohuri të mira dhe 8% shumë njohuri) mbi profilet politike të kandidatëve. Ndër 323 persona, 25% vlerësojnë se kanë pasur njohuri mesatare dhe 16% dhe 2% e të anketuarëve shprehen se kanë pasur pak ose aspak njohuri dhe informacion respektivisht. Lidhur me këtë pyetje, nuk vihen re diferenca në përgjigje ndërmjet dy gjinive.



Pyetur mbi ndikimin e profilit politik të kandidatit për kryetar bashkie në votën e qytetarit, rezultatet e pyetësorit tregojnë se 28% e të anketuarëve votojnë bazuar në profilin politik që kandidati për kryetar bashkie prezanton (pjesa më e madhe, 19% e të anketuarëve shprehen se vota e tyre është ndikuar mjaftueshëm nga profili politik i kandidatit). Personat që ndikohen mestarisht nga profili politik për të votuar përbëjnë 49% të të anketuarëve, ndërsa 23% shprehen se ndikohen pak ose aspak nga profili politik për të votuar. Femrat dhe meshkujt duken të kenë qasje të ngjashme në votimin e kandidatëve për kryetar bashkie ndikuar nga profili i tyre politik.

Bazuar mbi perceptimet e qytetarëve, të dhënat e pyetësorit tregojnë se 49% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët e kaluar për kryetar bashkie kanë pasur njohuri dhe kanë qenë të mjaftueshëm të informuar mbi problematikat e bashkisë në përgjithësi. 33% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët e kaluar kanë pasur njohuri mesatare dhe pjesa tjetër prej 12% dhe 6% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët kanë qenë pak ose aspak të informuar mbi problematikat e bashkisë që synonin të drejtonin. Të dhënat tregojnë për të njëjtin perceptim në përqindje si te femrat, ashtu edhe te meshkujt.

Në lidhje me perceptimin mbi transparencën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve, 32% e të anketuarëve shprehen se Bashkia Korçë është shumë ose mjaftueshëm transparente në ofrimin e shërbimeve, 39% shprehen se bashkia është mesatarisht transparente dhe pjesa tjetër prej 29% shprehen se bashkia është pak ose aspak transparente, pa pasur dallim të rëndësishme në perceptimin qytetar sipas gjinisë.




Të gjithë të anketuarit kanë shprehur perceptimin e tyre në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme publike në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secilin nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Vihet re se për secilin prej shërbimeve publike të ofruara, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhet rreth niveleve mesatare dhe mirë.


Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve publike të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[ujin e pijshëm, ujërat e ndotur, ujërat e shiut]	3%	7%	8%	12%	70%	100%
[rrugët dhe sinjalizimin rrugor, ndriçimin, trotualet dhe sheshet publike]	4%	10%	44%	34%	8%	100%
[transportin publik vendor]	9%	19%	44%	24%	3%	100%
[parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike]	5%	10%	28%	39%	17%	100%
[arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar]	5%	17%	43%	30%	5%	100%
[shëndetësinë]	9%	24%	44%	21%	1%	100%
[planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit]	5%	10%	23%	53%	10%	100%
[shërbimet sociale (krijimi dhe administrimi i shërbimeve, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social dhe qendrat përkatëse)]	7%	10%	23%	38%	22%	100%
[fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese]	5%	8%	22%	43%	22%	100%
[mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit]	5%	12%	30%	34%	19%	100%
bujqësinë dhe zhvillimin rural]	8%	24%	50%	16%	2%	100%
[zhvillimin ekonomik vendor (tregjet publike, bizneset e vogla, panairët, etj.)]	6%	10%	23%	48%	13%	100%
[sigurinë publike (mbrojtja civile, zjarrfikëse)]	6%	8%	20%	41%	25%	100%

Për shërbimet publike në përgjithësi, pjesa më e madhe e qytetarëve (50%) janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është mbi mesataren. Më problematike rezultojnë të jenë shërbimi i ofruar në lidhje me shëndetësinë dhe bujqësinë dhe zhvillimin rural ku 33% dhe 32% e të anketuarëve respektivisht thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimi i lidhur me ujin e pijshëm, ujërat e ndotur dhe ujërat e shiut është vlerësuar më mirë ku 82% e të anketuarëve shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



Pyetur mbi programet e shpenzimeve buxhetore dhe shërbimet e ofruara nga bashkia, qytetarët janë shprehur se sipas perceptimit të tyre, programet që duhet t'ju kushtohet më shumë rëndësi janë: Administrimi i Bashkisë, Arsimi, Infrastruktura rrugore, Mjedisi, Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave dhe Shërbimet publike vendore. Ndërkohë, për programin e perceptuar nga qytetarët si më të rëndësishëm, pesha e shpenzimeve nga bashkia kundrejt totalit të shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022 paraqitet si në grafik.




Qytetarët kanë shprehur perceptimin e tyre edhe në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve administrative në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Njësoj sikurse për shërbimet publike, edhe për shërbimet administrative vihet re se, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhet rreth niveleve mesatare dhe mirë.


Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve administrative të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia]	8%	41%	33%	11%	8%	100%
[dhënies së informacioneve në kohë të kërkuara nga qytetarët]	9%	15%	51%	22%	3%	100%
[informimin në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet e ndryshme në territorin e bashkisë]	9%	18%	42%	28%	3%	100%
[ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë]	9%	18%	40%	30%	3%	100%

Për shërbimet administrative, 24% e të anketuarëve janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është mbi mesataren. Më problematike rezulton të jetë shërbimi administrativ i lidhur me nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia ku 49% e të anketuarëve thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimi i lidhur me ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë është vlerësuar më mirë ku 33% e të anketuarëve shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



A e njihni të drejtën tuaj për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë?




Në Bashkinë Korçë, 72% e të anketuarëve nuk e njohin të drejtën për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë. Ndër 100 individë që e njohin këtë të drejtë vetëm 5% e tyre e ushtrojnë në mënyrë të vazhdueshme duke marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike. Një masë e konsiderueshme, 50% e këtyre individëve nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga Bashkia, ndërsa 29% e tyre kanë marrë pjesë disa herë ku pjesën më të madhe e përbëjnë femrat (20% kundrejt 9% e

meshkujve).


Rezultatet me bazë gjinore tregojnë se ekziston një hendek përsa i përket këtij treguesi, ku nga totali i qytetarëve që e njohin të drejtën e tyre, por nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto aktivitete, meshkujt zënë dy-fishin e peshës së femrave.

Personat të cilët u shprehën se kanë marrë pjesë të paktën një herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultimet publike të organizuara nga bashkia u pyetën nëse janë ndjerë të dëgjuar apo jo nga bashkia. Një pjesë e konsiderueshme, 35% u shpreh se janë ndjerë shumë ose mjaftueshëm të dëgjuar si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat që ata kanë shprehur, 29% mendojnë se janë dëgjuar mesatarisht dhe vetëm 36% mendojnë se nevojat dhe problematikat e ngritura nga ta janë dëgjuar pak ose aspak nga bashkia.


Sa herë keni marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga bashkia?



Sa jeni dëgjuar ju si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat e lidhura me pushtetin vendor?



BASHKIA LEZHË



Profili i Bashkisë

Bashkia Lezhë është bashkia më e madhe në Qarkun Lezhë dhe ka një popullsi prej 106'245 banorë sipas Regjistrimit Civil, ndërsa sipas Censurit (2011) ka një popullsi prej 65'633 banorësh. Ajo përbëhet nga 10 njësi administrative, më konkretisht, Lezhë, Shëngjin, Shënkoll, Zejmen, Kallmet, Dajç, Blinisht, Balldre, Kolsh, Ungrej. Me një sipërfaqe totale prej 509.1 km katrorë,

dendësia e popullsisë është 209 banorë/km katrorë sipas Regjistrimit Civil dhe 129 banorë/km katrorë sipas Censurit (2011).

Bashkia e Lezhës shtrihet në të dy anët e lumit Drin dhe pozicionohet në vijën bregdetare të Shëngjinit, duke ofruar mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit. Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit pritet të nxisë përqendrimin e bizneseve vendore dhe rajonale në këtë qytet. Pozicioni i favorshëm gjeografik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit, të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe rritjen e punësimit në Bashki. Bashkia e re do të ketë në territorin e saj qytetin e Shëngjinit dhe një vijë të gjatë bregdetare, e cila fillon nga rezervatet natyrore të mbrojtura të Bregut të Matit dhe të Kune-Vain-Tales deri te plazhet shkëmbore në veri të qytetit të Shëngjinit.



Këshilli Bashkiak i Lezhës është i përbërë nga 41 anëtarë zgjedhur me votë qytetare nga të cilët 17 janë femra dhe 24 meshkuj. Këshilli i zgjedhur ka gjithsej 15 anëtarë nga Partia Socialiste dhe 26 anëtarë nga parti të tjera të vogla të qendrës së majtë dhe të qendrës së djathtë.

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë


Bashkia Lezhë ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën, të cilat janë të mbuluara me burimet e veta ose transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Të dhënat duke filluar nga viti 2010 tregojnë se pesha e shpenzimeve të Bashkisë Lezhë me fondet e veta ka qenë në nivelet rreth 50%, ku duke filluar nga viti 2012, pjesa më e madhe e shpenzimeve të Bashkisë Lezhë është mbuluar nga fondet e veta të bashkisë. Ndryshe nga periudhat paraardhëse, shpenzimet e bashkisë me fondet e veta në vitin 2021 mbuluan 47.69% të shpenzimeve totale të bashkisë.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur shpenzimet sipas programeve buxhetore për 4-vjeçarin e fundit, 2019-2022 ku të dhënat për vitet 2019-2022 reflektojnë realizimin e shpenzimeve. Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 për Bashkinë Lezhë kanë shënuar rritje të konsiderueshme kundrejt vitit 2020 duke reflektuar kështu grantin për rindërtim të dëmtimeve të tërmetit dhjetor 2019. Edhe për vitin 2022 është rruajtur i njëjtë nivel shpenzimesh. Shërbimet më të financuar të bashkisë, në total për 4-vjeçarin e fundit, janë: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Rrjeti rrugor rural, Arsimi, Planifikimi urban vendor dhe furnizimi me ujë.


Shpenzimet sipas programeve buxhetore	2019	2020	2021	2022	2019-2022
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	478,678	516,814	493,626	533,603	19.89%
Rrjeti rrugor rural	343,030	128,542	233,043	322,166	10.10%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	248,101	167,050	399,362	172,668	9.71%
Planifikimi Urban Vendor	32,353	136,918	755,899	34,009	9.43%
Furnizimi me ujë	24,563	74,584	379,063	172,922	6.40%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	182,948	111,560	123,858	131,705	5.41%
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	91,010	106,661	133,729	154,916	4.78%
Menaxhimi i mbetjeve	109,022	74,491	89,740	105,588	3.72%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	18,950	17,890	18,879	241,444	2.92%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	90,697	73,401	33,764	26,157	2.20%
Arsimi profesional	15,235	15,648	47,793	140,026	2.15%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	55,052	57,481	39,947	44,489	1.94%
Shërbime publike vendore	43,351	31,024	50,377	56,836	1.79%
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	27,212	43,472	69,186	39,017	1.76%
Ndriçim rrugësh	16,193	54,456	23,641	50,370	1.42%
Çështje financiare dhe fiskale	41,889	31,345	32,954	30,361	1.34%
Shërbimet bujqësore inspektimi ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	21,238	21,240	16,221	19,077	0.76%
Sport dhe argëtim	30,743	9,776	9,308	25,016	0.74%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	19,676	15,002	12,669	12,936	0.59%
Shërbimet e Policisë Vendore	16,656	9,971	10,976	11,347	0.48%
Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	11,202	10,996	11,186	11,089	0.44%
Gjendja civile	8,104	12,526	8,478	8,601	0.37%
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	8,342	5,664	10,398	9,894	0.34%
Zhvillimi i turizmit	10,655	7,418	8,280	7,076	0.33%

Strehimi social	5,968	3,689	4,121	4,182	0.18%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	1,686	1,759	1,763	1,715	0.07%
Marredheniet me komunitetin	0	0	2,084	4,742	0.07%
Total	1,953,298	2,134,403	3,030,371	3,053,028	100%

Grafiku ofron një paraqitje të programeve kryesore buxhetore të Bashkisë Lezhë, sipas peshës mesatare që secili prej tyre zë në totalin e shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022. (Periudha 2019-2021 i referohet buxhetit faktik, ndërsa ajo për vitin 2022 i referohet planit të buxhetit).





Programet buxhetore të Bashkisë Lezhë kanë pësuar ndryshime me kalimin e viteve, duke treguar për rëndësinë në rritje të disa prej këtyre zërave nga ana e pushtetit vendor. Programet për të cilat bashkia ka rritur fokusin përgjatë 4-vjeçarit 2019-2022 janë: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore; Marrëdhëniet me komunitetin dhe Arsimi profesional, ndërsa programet që kanë pasur tendencë rënëse të shpenzimeve janë: Planifikimi urban vendor dhe Arsimi i mesëm i përgjithshëm. Struktura katër-vjeçare e shpenzimeve nga viti 2019 në vitin 2022 paraqitet grafikisht si më poshtë.





Rezultatet e Studimit

Në Bashkinë Lezhë numri total i qytetarëve të intervistuar është 315, ndër të cilët 44% janë femra dhe 56% meshkuj. Të gjitha grupmoshat e popullatës që kanë të drejtë për të votuar u përfshinë në pyetësor ku shpeshitë më të lartë e përbën grupmosha 18-24 vjeç me 27% të të anketuarëve dhe atë më të ulët e përbën grupmosha 65+ vjeç me 9% të të anketuarëve.





Niveli i arsimit i arritur të të anketuarëve varion nga arsimi i ulët 9 vjeçar deri në arritjen e diplomës së masterit, ku 42% e të anketuarëve u shprehen se zotëronin diplomën e shkollës së mesme, ndërsa 46% e tyre kishin përfunduar minimalisht studimet universitare (konkretisht 23% kishin përfunduar bachelor-in dhe 23% kishin përfunduar studimet master).



Përsa i përket statusit të punësimit, 23% e të anketuarëve rezultojnë të punësuar me kohë të plotë, 8% janë të punësuar me kohë të pjesshme, 28% janë të vetëpunësuar, ndërsa 22% janë të papunë. Jashtë forcave të punës llogaritet të jenë 19% e të anketuarëve.



28% e të anketuarëve (88 individë) janë shprehur se nuk kanë votuar asnjëherë më parë në zgjedhjet lokale të Bashkisë Lezhë, ku shumicën prej tyre e kanë përbërë të intervistuarat femra. Pyetur mbi arsyet e mosvotimit, 33% e këtyre individëve janë shprehur se nuk kishin mbushur moshën për të pasur të drejtën e votimit. Rrjedhimisht vëmendja duhet të drejtohet drejt 67% të të anketuarëve që nuk kanë votuar për të kuptuar arsyet që çojnë në mos angazhimin në votime të qytetarëve. 14 individë shprehen se nuk kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në votime, ndërsa 16 individë nuk kanë pasur besim tek kandidatët për kryetar bashkie. Pjesa tjetër e të anketuarëve, 20 individë gjithsej, shprehen se nuk kanë pasur interes në votime. Vihet re që ndërmjet personave që kanë pasur të drejtë të votonin, por nuk kanë votuar, nuk ka diferenca të rëndësishme ndërmjet femrave dhe meshkujve.





Personat të cilët kishin votuar minimalisht njëherë gjatë zgjedhjeve lokale të Bashkisë Lezhë, u pyetën sa njohuri kanë pasur mbi profilin politik të Kryetarit/ëve të Bashkisë për të cilin/ët kanë zgjedhur të votojnë. Ndër 315 persona të përgjigjur, 31% u shprehën se kanë pasur njohuri mbi mesataren (23% kanë pasur njohuri të mira dhe 8% shumë njohuri) mbi profilet politike të kandidatëve. Ndër 315 persona, pjesa më e madhe e tyre prej 46% vlerësojnë se kanë pasur njohuri mesatare dhe 13% dhe 10% e të anketuarëve shprehen se kanë pasur pak dhe aspak njohuri dhe informacion respektivisht. Lidhur me këtë pyetje, nuk vihen re diferenca në përgjigje ndërmjet dy gjinive, me përjashtim të atyre që janë shprehur se kanë pasur nivel mesatar njohurish, ku përqindja e meshkujve është gati dy-fish sa ajo e femrave.



Pyetur mbi ndikimin e profilit politik të kandidatit për kryetar bashkie në votën e qytetarit, rezultatet e pyetësorit tregojnë se 43% e të anketuarëve votojnë bazuar në profilin politik që kandidati për kryetar bashkie prezanton, ku 16% e të anketuarëve shprehen se vota e tyre është ndikuar shumë nga profili politik i kandidatit. Personat që ndikohen mestarisht nga profili politik për të votuar përbëjnë peshën më të madhe me 34% të të anketuarëve, ndërsa 23% shprehen se ndikohen pak ose aspak nga profili politik për të votuar. Pesha e meshkujve të cilët shprehen se ndikohen në nivel të paktën mesatar në votimin e kandidatëve për kryetar bashkie ndikuar nga profili i tyre politik është relativisht më e madhe se ajo e femrave.

Bazuar mbi perceptimet e qytetarëve, të dhënat e pyetësorit tregojnë se 28% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët e kaluar për kryetar bashkie kanë pasur njohuri dhe kanë qenë të mirë informuar mbi problematikat e bashkisë në përgjithësi (vetëm 8% e të anketuarëve mendojnë se njohuritë e kandidatëve kanë qenë shumë të mira). 39% e tyre mendojnë se kandidatët e kaluar kanë pasur njohuri mesatare dhe pjesa tjetër prej 19% dhe 14% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët kanë qenë pak ose aspak të informuar mbi problematikat e bashkisë që synonin të drejtonin. Të dhënat tregojnë për perceptime të përafërta në përqindje si te femrat, ashtu edhe te meshkujt.

Në lidhje me perceptimin mbi transparencën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve, 36% e të anketuarëve shprehen se Bashkia Lezhë është shumë ose mjaftueshëm transparente në ofrimin e shërbimeve, 37% shprehen se bashkia është mesatarisht transparente dhe pjesa tjetër prej 27% shprehen se bashkia është pak ose aspak transparente, pa pasur dallim të rëndësishme në perceptimin qytetar sipas gjinisë.




Të gjithë të anketuarit kanë shprehur perceptimin e tyre në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme publike në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Vihet re se për secilin prej shërbimeve publike të ofruara, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhet rreth niveleve shumë keq dhe mesatar.


Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve publike të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[ujin e pijshëm, ujërat e ndotur, ujërat e shiut]	14%	22%	48%	14%	3%	100%
[rrugët dhe sinjalizimin rrugor, ndriçimin, trotualet dhe sheshet publike]	10%	25%	45%	17%	3%	100%
[transportin publik vendor]	22%	23%	39%	13%	2%	100%
[parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike]	14%	21%	40%	20%	5%	100%
[arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar]	8%	23%	42%	22%	4%	100%
[shëndetësinë]	11%	28%	34%	24%	3%	100%
[planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit]	9%	30%	35%	23%	4%	100%
[shërbimet sociale (krijimi dhe administrimi i shërbimeve, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social dhe qendrat përkatëse)]	12%	27%	38%	19%	3%	100%
[fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese]	11%	25%	38%	22%	4%	100%
[mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit]	10%	29%	38%	20%	3%	100%
bujqësinë dhe zhvillimin rural]	11%	30%	35%	20%	3%	100%
[zhvillimin ekonomik vendor (tregjet publike, bizneset e vogla, panairet, etj.)]	11%	32%	33%	21%	3%	100%
[sigurinë publike (mbrojtja civile, zjarrfikëse)]	10%	25%	39%	23%	3%	100%

Për shërbimet publike në përgjithësi, pjesa më e madhe e qytetarëve (48%) janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është mesatar. Më problematike rezultojnë të jenë shërbimi i ofruar në lidhje me transportin publik vendor dhe zhvillimin ekonomik vendor ku 45% dhe 43% e të anketuarëve respektivisht thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimet e lidhur me arsimin dhe shëndetësinë janë vlerësuar më mirë ku 27% e të anketuarëve respektivisht shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



Pyetur mbi programet e shpenzimeve buxhetore dhe shërbimet e ofruara nga bashkia, qytetarët janë shprehur se sipas perceptimit të tyre, programet që duhet t'ju kushtohet më shumë rëndësi janë: Shërbimet publike vendore, Strehimi dhe shërbimet sociale, Arsimi, Kultura, Sporti, Turizmi dhe Rinia dhe Infrastruktura rrugore. Ndërkohë, për programin e perceptuar nga qytetarët si më të rëndësishëm, përsa shpenzimeve nga bashkia kundrejt totalit të shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022 paraqitet si në grafik. Pas një ulje në vitin 2020, pjesa e buxhetit e adresuar për shërbimet publike vendore është ulur. Në total për 4 vjeçarin 2019-2022, bashkia ka shpenzuar 1.79% të buxhetit të saj për këtë shërbim.




Pas një ulje në vitin 2020, pjesa e buxhetit e adresuar për shërbimet publike vendore është ulur. Në total për 4 vjeçarin 2019-2022, bashkia ka shpenzuar 1.79% të buxhetit të saj për këtë shërbim.


Qytetarët kanë shprehur perceptimin e tyre edhe në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve administrative në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Krahasuar me shërbimet publike, për shërbimet administrative vihet re një vlerësim më i lartë nga ana e qytetarëve të anketuar mbi nivelin e këtyre shërbimeve, që luhaten rreth niveleve shumë keq dhe mirë.

Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve administrative të lidhura me:						
	1	2	3	4	5	Totali
[nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia]	13%	19%	46%	20%	2%	100%
[dhënies së informacioneve në kohë të kërkuara nga qytetarët]	10%	21%	51%	16%	2%	100%
[informimin në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet e ndryshme në territorin e bashkisë]	11%	24%	48%	16%	2%	100%
[ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë]	10%	30%	36%	22%	3%	100%

Për shërbimet administrative, 46% e të anketuarëve janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është mesatar. Më problematike rezulton të jetë shërbimi administrativ i lidhur me ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë ku 40% e të anketuarëve thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimi i lidhur me dhënien në kohë të informacioneve të ndryshme është vlerësuar më mirë ku 69% e të anketuarëve shprehen se niveli i ofruar është mesatar ose mirë.



A e njihni të drejtën tuaj për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë?




Në Bashkinë Lezhë, 64% e të anketuarëve e njohin të drejtën për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë por vetëm 5% e tyre e ushtrojnë këtë të drejtë në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet tregojnë se 11% e këtyre individëve kanë marrë pjesë disa herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga Bashkia dhe 15% e tyre kanë marrë pjesë vetëm një herë. Në masë të konsiderueshme, 69% nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto mbledhje pavarësisht se e njohin këtë si një të drejtë qytetare.


Rezultatet me bazë gjinore tregojnë se ekziston një hendek përse i përket këtij treguesi, ku nga totali i qytetarëve që e njohin të drejtën e tyre, por nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto aktivitete, meshkujt zënë dy-fishin e peshës së femrave, dhe rreth gjysmën e peshës për pjesëmarrjet me të paktën njëherë.

Personat të cilët u shprehën se kanë marrë pjesë të paktën një herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultimet publike të organizuara nga bashkia u pyetën nëse janë ndjerë të dëgjuar apo jo nga bashkia. 31% e tyre u shpreh se janë ndjerë shumë ose mjaftueshëm të dëgjuar si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat që ata kanë shprehur, pjesa më e madhe prej 42% mendojnë se janë dëgjuar mesatarisht dhe 27% mendojnë se nevojat dhe problematikat e ngritura nga ta janë dëgjuar pak ose aspak nga bashkia.

Sa herë keni marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga bashkia?



Sa jeni dëgjuar ju si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat e lidhura me pushtetin vendor?



BASHKIA SHKODËR



Profili i Bashkisë

Bashkia Shkodër është bashkia më e madhe në Qarkun Shkodër dhe ka një popullsi prej 200'889 banorë sipas Regjistrimit Civil, ndërsa sipas Censurit (2011) ka një popullsi prej 135'612 banorësh. Ajo përbëhet nga 11 njësi administrative, më konkretisht, Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Me një sipërfaqe totale prej 872.71 km katror, dendësia e popullsisë është 230 banorë/km katror sipas Regjistrimit Civil dhe 155 banorë/km katror sipas Censurit (2011). Qyteti i

Shkodrës, me rreth 115 mijë banorë, ka aktualisht rreth 55% të popullsisë së bashkisë, ndërsa pjesa tjetër është e ndarë përkatësisht në njësitë administrative.

Bashkia e Shkodrës ndodhet e pozicionuar mënyrë strategjike në bregdetin e detit Adriatik dhe ka një pasuri të burimeve ujore si liqeni i Shkodrës dhe lumi Buna që kalon përmes qytetit dhe zonave përreth. dhe ka një pasuri të burimeve ujore që kontribuojnë në ekonominë lokale dhe një peizazh të jashtëzakonshëm që tërheq një numër në rritje turistësh nga rajoni dhe me gjere. Një epiqendër e kulturës shqiptare, qyteti i Shkodrës përmban një sërë atraksionesh turistike dhe historike. Ekonomia lokale bazohet kryesisht në prodhimtari, bujqësi dhe shërbime.



Këshilli Bashkiak i Shkodrës është i përbërë nga 51 anëtarë zgjedhur me votë qytetare nga të cilët 25 janë femra dhe 26 meshkuj. Këshilli i zgjedhur ka gjithsej 40 anëtarë nga Partia Socialiste dhe 11 anëtarë nga parti të tjera të vogla të qendrës së majtë dhe të qendrës së djathtë.


Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore të Bashkisë

Bashkia Shkodër ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën, të cilat janë të mbuluara me burimet e veta ose transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Të dhënat duke filluar nga viti 2010 tregojnë se pesha e shpenzimeve të Bashkisë Lezhë me fondet e veta ka qenë në nivelet nën 50% deri në vitin 2016, ndërsa në vitet në vijim ky tregues ka pësuar një trend përgjithësisht rritës. Shpenzimet e bashkisë me fondet e veta në vitin 2021 mbuluan 60.23% të shpenzimeve totale të bashkisë.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur shpenzimet sipas programeve buxhetore për 4-vjeçarin e fundit, 2019-2022 ku të dhënat për vitet 2019-2022 reflektojnë realizimin e shpenzimeve. Shpenzimet buxhetore për vitet 2019-2022 për Bashkinë Shkodër në përgjithësi kanë qenë konsistente duke rruajtur të njëjtë nivel shpenzimesh me rritje relativisht të vogla. Shërbimet më të financuar të bashkisë, në total për 4-vjeçarin e fundit, janë: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët, Rrjeti rrugor rural, Arsimi, Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi, Arsimi dhe Menaxhimi i Mbetjeve.

Shpenzimet sipas programeve buxhetore	2019	2020	2021	2022	2019-2022
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	910,003	1,091,268	1,034,911	1,110,571	36.30%
Rrjeti rrugor rural	508,845	302,106	391,979	315,472	13.29%
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	270,265	245,534	236,528	246,398	8.74%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	266,134	260,478	274,607	52,347	7.47%
Menaxhimi i mbetjeve	190,656	131,593	121,313	183,173	5.49%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	48,033	111,788	72,413	328,767	4.91%
Sport dhe argëtim	141,993	104,715	142,520	68,350	4.01%
Ndriçim rrugësh	102,904	106,644	108,869	115,121	3.80%
Shërbime publike vendore	93,290	78,943	62,160	88,245	2.82%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	77,997	71,887	77,680	89,863	2.78%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	49,985	48,876	56,479	65,930	1.94%
Arsimi profesional	62,263	11,815	24,037	111,882	1.84%
Strehimi social	7,752	69,933	54,436	25,025	1.38%
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	46,172	29,862	31,148	26,638	1.17%
Furnizimi me ujë	41,408	18,585	9,016	16,924	0.75%
Shërbimet e Policisë Vendore	16,324	22,211	18,967	20,814	0.69%
Gjendja civile	20,207	17,091	15,407	15,339	0.60%
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	15,640	14,710	13,998	15,000	0.52%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	13,270	11,821	13,076	20,329	0.51%
Të tjera	1,037	11,553	18,420	5,982	0.32%
Transporti publik	10,658	4,450	3,047	6,077	0.21%
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	5,528	5,114	5,691	4,190	0.18%
Zhvillimi i turizmit	3,563	2,624	4,160	3,946	0.13%
Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	1,656	1,014	1,917	5,151	0.09%
Totali	2,905,583	2,774,971	2,792,779	2,950,183	100%

Grafiku ofron një paraqitje të programeve kryesore buxhetore të Bashkisë Shkodër, sipas peshës mesatare që secili prej tyre zë në totalin e shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022. (Periudha 2019-2021 i referohet buxhetit faktik, ndërsa ajo për vitin 2022 i referohet planit të buxhetit).





Programet buxhetore të Bashkisë Shkodër kanë pësuar ndryshime me kalimin e viteve, duke treguar për rëndësinë në rritje të disa prej këtyre zërave nga ana e pushtetit vendor. Programet për të cilat bashkia ka rritur fokusin përgjatë 4-vjeçarit 2019-2022 janë: Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe ai profesional dhe Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve, ndërsa programet që kanë pasur tendencë rënëse në strukturën e shpenzimeve janë: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor dhe Sport dhe argëtim. Struktura katër-vjeçare e shpenzimeve nga viti 2019 në vitin 2022 paraqiten grafiksht si më poshtë.





Rezultatet e Studimit

Në Bashkinë Shkodër numri total i qytetarëve të intervistuar është 316, ndër të cilët 55% janë femra dhe 45% meshkuj. Të gjitha grupmoshat e popullatës që kanë të drejtë për të votuar u përfshinë në pyetësor ku shpeshësinë më të lartë e përbën grupmosha 25-34 vjeç me 27% të të anketuarëve dhe atë më të ulët e përbën grupmosha 65+ vjeç me 11% të të anketuarëve.





Niveli i arsimit i arritur të të anketuarëve varion nga arsimi i ulët 9 vjeçar deri në arritjen e gradës doktor shkencave, ku 28% e të anketuarëve u shprehën se zotëronin diplomën e shkollës së mesme, ndërsa 65% e tyre kishin përfunduar studimet universitare (konkretisht 22% kishin përfunduar bachelor-in dhe 43% kishin përfunduar studimet master).



Përsa i përket statusit të punësimit, 46% e të anketuarëve rezultojnë të punësuar me kohë të plotë, 8% janë të punësuar me kohë të pjesshme, 19% janë të vetëpunësuar, ndërsa 16% janë të papunë. Jashtë forcave të punës llogaritet të jenë 11% e të anketuarëve të cilët rezultojnë të jenë kryesisht femra.



Vetëm 5% e të anketuarëve janë shprehur se nuk kanë votuar asnjëherë më parë në zgjedhjet lokale të Bashkisë Shkodër, ku shumicën prej tyre e kanë përbërë të intervistuarat femra. Pyetur mbi arsyet e mosvotimit, 44% e këtyre individëve janë shprehur se nuk kishin mbushur moshën për të pasur të drejtën e votimit. Rrjedhimisht vëmendja duhet të drejtohet drejt 56% të të anketuarëve që nuk kanë votuar për të kuptuar arsyet që çojnë në mos angazhimin në votime të qytetarëve. Rreth 25% e të anketuarëve shprehen se nuk kanë pasur interes në votime dhe po 25% shprehen se nuk kanë pasur besim tek kandidatët. Në të dyja këto kategori femrat zënë pjesën më të mashe. Në pjesë relativisht e vogël e të anketuarëve (6%) shprehen se nuk kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në votime. Vihet re që personat që janë shprehur se nuk kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në votime janë të gjithë meshkuj.





Personat të cilët kishin votuar minimalisht njëherë gjatë zgjedhjeve lokale të Bashkisë Shkodër, u pyetën sa njohuri kanë pasur mbi profilin politik të Kryetarit/ëve të Bashkisë për të cilin/ët kanë zgjedhur të votojnë. Ndër 300 persona të përgjigjur, 58% u shprehën se kanë pasur njohuri mbi mesataren (32% kanë pasur njohuri të mira dhe 26% shumë njohuri) mbi profilet politike të kandidatëve. Ndër 300 persona 22% vlerësojnë se kanë pasur njohuri mesatare dhe 20% e të anketuarëve shprehen se kanë pasur pak ose aspak njohuri dhe informacion. Lidhur me këtë pyetje, nuk vihen re diferenca në përgjigje ndërmjet dy gjinive.



Pyetur mbi ndikimin e profilit politik të kandidatit për kryetar bashkie në votën e qytetarit, rezultatet e pyetësorit tregojnë se 47% e të anketuarëve votojnë bazuar në profilin politik që kandidati për kryetar bashkie prezanton (pjesa më e madhe, 24% e të anketuarëve shprehen se vota e tyre është ndikuar mjaftueshëm nga profili politik i kandidatit). Personat që ndikohen mestarisht nga profili politik për të votuar përbëjnë 23% të të anketuarëve, ndërsa 30% shprehen se ndikohen pak ose aspak nga profili politik për të votuar. Femrat dhe meshkujt rezultojnë të kenë qasje të ngjashme në votimin e kandidatëve për kryetar bashkie ndikuar nga profili i tyre politik por meshkujt duken lehtësisht më të ndikuar se femrat.

Bazuar mbi perceptimet e qytetarëve, të dhënat e pyetësorit tregojnë se 37% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët e kaluar për kryetar bashkie kanë pasur njohuri dhe kanë qenë të mirë informuar mbi problematikat e bashkisë në përgjithësi (13% mendojnë se njohuritë e kandidatëve kanë qenë shumë të mira). 28% e tyre mendojnë se kandidatët e kaluar kanë pasur njohuri mesatare dhe pjesa tjetër prej 20% dhe 15% e të anketuarëve mendojnë se kandidatët kanë qenë pak ose aspak të informuar mbi problematikat e bashkisë që synonin të drejtonin. Të dhënat tregojnë për të njëjtin perceptim në përqindje si te femrat, ashtu edhe te meshkujt.


Në lidhje me perceptimin mbi transparencën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve kundrejt qytetarëve, 22% e të anketuarëve shprehen se Bashkia Shkodër është shumë ose mjaftueshëm transparente në ofrimin e shërbimeve, 24% shprehen se bashkia është mesatarisht transparente dhe pjesa tjetër prej 54% shprehen se bashkia është pak ose aspak transparente, pa pasur dallim të rëndësishme në perceptimin qytetar sipas gjinisë.




Të gjithë të anketuarit kanë shprehur perceptimin e tyre në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme publike në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Vihet re se për secilin prej shërbimeve publike të ofruara, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhatet rreth niveleve shumë keq, keq dhe mesatar,

Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve publike të lidhura me:						
	1	2	3	4	5	Totali
[ujin e pijshëm, ujërat e ndotur, ujërat e shiut]	23%	30%	30%	15%	2%	100%
[rrugët dhe sinjalizimin rrugor, ndriçimin, trotualet dhe sheshet publike]	33%	33%	25%	10%	0%	100%
[transportin publik vendor]	45%	30%	18%	5%	3%	100%
[parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike]	33%	37%	17%	9%	2%	100%
[arsimin parashkollor dhe atë parauniversitar]	18%	39%	30%	10%	3%	100%
[shëndetësinë]	22%	35%	30%	9%	3%	100%
[planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit]	24%	41%	21%	9%	4%	100%
[shërbimet sociale (krijimi dhe administrimi i shërbimeve, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehim social dhe qendrat përkatëse)]	22%	32%	33%	10%	3%	100%
[fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese]	23%	37%	26%	10%	3%	100%
[mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit]	26%	36%	25%	9%	4%	100%
bujqësinë dhe zhvillimin rural]	27%	41%	20%	9%	3%	100%
[zhvillimin ekonomik vendor (tregjet publike, bizneset e vogla, panaiet, etj.)]	28%	38%	22%	8%	4%	100%
[sigurinë publike (mbrojtja civile, zjarrfikëse)]	22%	26%	36%	10%	5%	100%

Për shërbimet publike në përgjithësi, pjesa më e madhe e qytetarëve (61%) janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është poshtë mesatares. Më problematike rezultojnë të jenë shërbimi i ofruar në lidhje me transportin publik vendor dhe hapësirat e gjelbra publike ku 75% dhe 70% e të anketuarëve respektivisht thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimet e lidhur me ujin e pijshëm, ujërat e ndotur, ujërat e shiut dhe sigurinë publike janë vlerësuar më mirë ku 17% dhe 16% e të anketuarëve respektivisht shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



Pyetur mbi programet e shpenzimeve buxhetore dhe shërbimet e ofruara nga bashkia, qytetarët janë shprehur se sipas perceptimit të tyre, programet që duhet t'ju kushtohet më shumë rëndësi janë: Shërbimet publike vendore, Kultura, Sporti, Turizmi dhe Rinia, Infrastruktura rrugore. Pas një ulje në vitin 2020 dhe 2021, pjesa e buxhetit e adresuar për shërbimet publike vendore është rritur për 2022.



Në total për 4 vjeçarin 2019- 2022, bashkia ka shpenzuar 2,82% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Ndërkohë, për programin e perceptuar nga qytetarët si më të rëndësishëm, pesha e shpenzimeve nga bashkia kundrejt totalit të shpenzimeve bashkiake për periudhën 2019-2022 paraqitet si në grafik.

Qytetarët kanë shprehur perceptimin e tyre edhe në lidhje me nivelin e ofrimit të shërbimeve administrative në shkallë lineare, ku 1 përfaqëson vlerësimin shumë keq, ndërsa 5 përfaqëson vlerësimin shumë mirë. Të dhënat në përqindje sipas peshës që përfaqëson secil nivel vlerësimi nga ana e qytetarëve janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Njësoj sikurse për shërbimet publike, edhe për shërbimet administrative vihet re se, pjesa më e madhe e qytetarëve janë shprehur se sipas perceptimit të tyre niveli i ofrimit luhetet rreth niveleve shumë keq, keq dhe mesatar.


Sipas perceptimit tuaj, si është niveli i ofrimit të shërbimeve administrative të lidhura me:

	1	2	3	4	5	Totali
[nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia]	16%	35%	31%	16%	3%	100%
[dhënies së informacioneve në kohë të kërkuara nga qytetarët]	21%	36%	31%	9%	3%	100%
[informimin në kohë të qytetarëve mbi zhvillimet e ndryshme në territorin e bashkisë]	30%	35%	21%	9%	4%	100%
[ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë]	33%	32%	24%	8%	3%	100%

Për shërbimet administrative, 59% e të anketuarëve janë shprehur se niveli i ofrimit të shërbimeve është poshtë mesatares. Më problematike rezulton të jetë shërbimi administrativ i lidhur me ofrimin e konsulencës për qytetarët për çdo problematikë që lidhet me fushat e përgjegjësisë së bashkisë ku 65% e të anketuarëve thonë se niveli i ofruar është poshtë mesatares. Shërbimi i lidhur me nxjerrjen në kohë të dokumenteve të ndryshme që gjenerohen nga bashkia] është vlerësuar më mirë ku 19% e të anketuarëve shprehen se niveli i ofruar është mbi mesataren.



A e njihni të drejtën tuaj për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë?




Në Bashkinë Shkodër, 72% e të anketuarëve e njohin të drejtën për pjesëmarrje qytetare në proceset vendimmarrëse të bashkisë por vetëm 10% e tyre e ushtrojnë këtë të drejtë në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet tregojnë se 28% e të anketuarëve kanë marrë pjesë disa herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga Bashkia dhe 15% e tyre kanë marrë pjesë vetëm një herë. Një masë e konsiderueshme, 47% nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto mbledhje pavarësisht se e njohin këtë si një të drejtë qytetare.


Rezultatet me bazë gjinore tregojnë se ekziston një diferenca të vogla përsa i përket këtij treguesi, ku nga totali i qytetarëve që e njohin të drejtën e tyre, por nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto aktivitete pjesën më të madhe e përbëjnë femrat, 27% kundrejt 20% meshkuj.

Personat të cilët u shprehën se kanë marrë pjesë të paktën një herë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultimet publike të organizuara nga bashkia u pyetën nëse janë ndjerë të dëgjuar apo jo nga bashkia. Një pjesë e konsiderueshme, 35% u shpreh se janë ndjerë shumë ose mjaftueshëm të dëgjuar si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat që ata kanë shprehur, 17% mendojnë se janë dëgjuar mesatarisht dhe 48% mendojnë se nevojat dhe problematikat e ngritura nga ta janë dëgjuar pak ose aspak nga bashkia.

Sa herë keni marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak ose në konsultime publike të organizuara nga bashkia?



Sa jeni dëgjuar ju si qytetarë nga bashkia mbi nevojat dhe problematikat e lidhura me pushtetin vendor?



Fondazioni Qemal Stafa

www.fqs.al

secretary@fqs.al